



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 03.07.2018, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Albana Vokshi – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 19 qershor 2018.
2. Seancë dëgjimore me aktorë të interesit për projektligjin "Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt "Projektimin dhe realizimin e projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar" (*komision për dhënie mendimi*).
3. Fillon diskutimi dhe votimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjit "Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt "Projektimi dhe realizimin e projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar" (*komision për dhënie mendimi*).

Marrin pjesë:

Albana Vokshi, Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Fatmir Velaj, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Valentina Duka, Romeo Gurakuqi, Sezai Rrokaj, Nora Malaj dhe Kejdi Mehmetaj

Të ftuar:

Elsa Demo – gazetare
Sokol Angjeli - aktor
Enida Bozhegu - juriste
Robert Budina – regjisor

Apollon Baçi – akademik

Edmond Ahmeti - Drejtor në Drejtorinë e Koncesioneve, Prokurimeve dhe Partneriteteve
në Ministrinë e Kulturës

Fatmir Hoxhaj – Drejtor i Administrimit të Pronës në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financës

Stefan Kocollari – Përgjegjës sektori në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financës

HAPET MBLEDHJA

Albana Vokshi – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Sot në rendin e ditës si pikë të parë kemi miratimin e procesverbalit të datës 19 qershor 2018. Jeni dakord me procesverbalin? Keni komente?

Nëse jeni dakord, miratohet!

Pika e dytë e rendit të ditës: meqenëse projektligji “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt "Projektimin dhe realizmin e projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar", për të cilin jemi komision për dhënie mendimi, me anë të vendimit të miratuar në seancën e parlamentit të enjten e kaluar, është në rendin e ditës së seancës së ardhshme të datës 5 korrik, jemi të detyruar që mbledhjet t’i bëjmë të ngjeshura.

Sot do të kemi edhe disa dëgjesa në lidhje me mendimin e disa prej grupeve të interesit, që kanë shprehur dëshirën për të ardhur në komisionin tonë. Kjo është dëgjesa e parë, ndërkohë që në orën 16:00 edhe Komisioni për Veprimtarinë prodhuese do të ketë një dëgjesë tjetër. Pra, kushdo që është i interesuar që të japë mendim rreth këtij projektligji, jam e sigurt që do të ketë hapësirë edhe te komisioni i kryesuar nga zoti Shalsi.

Pas një ndërprerje disa minutëshe, do të na duhet ta vazhdojmë përsëri mbledhjen e këtij komisioni për diskutimin nen për nen të këtij projektligji dhe më pas votimin në tërësi të tij.

Meqenëse kemi ditë shumë të ngjeshur dhe të gjitha komisionet do të kenë paralelisht, apo në orë të ndryshme të ditës, diskutimin e të njëjtit projektligj, pa humbur kohë, do të doja t’ua jepja fjalën të ftuarve në dëgjesën për këtë projektligj, apo në tërësi në lidhje me çështjen e Teatrit Kombëtar, që është një çështje shumë sensitive, e sensibilizuar më së shumti pas planit të qeverisë për të prishur godinën e Teatrit Kombëtar.

Të ftuar janë: Elsa Demo, Sokol Angjeli, Eneida Bozheku, Robert Budina dhe zoti Apollon Baçe.

Nëse jeni dakord, do të doja t’ia kaloj fjalën, së pari, zotit Apollon Baçe.

Fjala për ju, zoti Baçe!

Mendoj se 7 deri në 10 minuta është kohë e mjaftueshme për gjithsecilin prej jush.

Apollon Baçe – Përshëndetje!

Dikur kam qenë drejtor i Institutit dhe në atë kohë u tentua të prishej Piramida. Mjaft nga nëpunësit e shtetit të asaj periudhe dhe një pjesë e mirë e PD-së ishin kundër prishjes së Piramidës, secili mendonte me mendjen e vet, se, në fund të fundit, “Iluminizmi - thotë Kanti, - është që secili mendon me mendjen e vet dhe jo me mendjen e tjetrit”.

Këtë do të mundohem ta ndaj në dy blloqe: në njërin prej tyre janë vlerat historike të Teatrit dhe, në bllokun e dytë, ana ligjore e tij.

Pa e politizuar, do të thosha që për Kryeministrin, zotin Rama, kam mjaft respekt si intelektual, për performimin e tij intelektual e rendis ndër piktorët e mirë shqiptarë, por nuk e pranoj si kritik arti. Nuk jam në një mendim me të që, gjatë ceremonisë së qendrës “Art Turbina”, se çfarë ka të bëjë arti me turbinën, këtë nuk e kam shumë të qartë, tha se godina e Teatrit nuk është pjesë e histories dhe sikur të kishte një “UEFA” për teatrot, ky yni do të ishte në listën e zezë prej 70 vjetësh.

Giulio Berte, që e ka projektuar këtë teatër, është pjesë e historisë së arkitekturës botërore të racionalizmit monumental.

Në vitet '30, më lejoni që të hapem pak, ka pasur tri shkolla: shkolla gjermane e “Bauhaus”-it, në Rusi konstruktivizmi i “Tatlini”-t dhe në Itali ka qenë shkolla e “Grupi 7”. Me ardhjen në fuqi të Hitlerit dhe Stalinit, u mbyllën të dyja dhe e vetmja herë që u la...

(Diskutim pa mikrofon.)

Mund të vazhdoj?

Albana Vokshi – Na falni, zoti Baçe!

Ka shumë interes, ndaj dhe, siç e shikoni, është pak problem...

Apollon Baçe – Në vitet ‘20- ‘30 pati një shkollë të konstruktivizmit racional. Në vitet '30 në Gjermani ka qenë shkolla e “Bauhaus”-it, në Rusi ka qenë shkolla e “Tatlini”-t dhe në Itali shkolla e “Grupi 7”. Hitleri i mbylli shkollat e dy vendeve të para dhe dëboi “Bauhaus”-in, Stalini bëri po të njëjtën gjë, “Tatlini”-in e zëvendësoi me të tjerët, me artin sovjetik dhe i vetmi që e ka thënë këtë fjalë, mos kujtoni se e ka thënë Mao Ce Duni këtë frazë: “Të lulëzojnë 100 lulet”, por ka qenë thënie e Musolinit, i cili ishte i pari që e la këtë shkollë të vazhdonte në linjat e saj.

Në rast se në Romë dhe në vende të tjera ka pasur një farë kontrolli, Siberia ka qenë vendi në të cilin ajo ka lulëzuar në maksimumin e saj. Mund t’ju them se në historinë e arkitekturës botërore një pjesë është Banka e Shtetit e bërë nga Mopurgio, hotel “Dajti” dhe Teatri Kombëtar.

Pra, është disi e çuditshme, por Teatri në format e tij kishte edhe një lloj pishine që është në Itali, në Empoli. Ju mendoni se grupi që e ka bërë këtë, me në krye Bertin, më saktë, ishin arkitektë të panjohur, por, në fakt, ai grup ishte pjesë e grupit që ka bërë qendrën e Eritreas, të kryeqytetit, e cila u vu në mbrojtje të UNESCO-s dhe sot vizitohet nga e gjithë bota.

Kur unë kam qenë në Itali, kam parë se atje mundohen vazhdimisht që ato pak monumente që kanë ngelur nga kjo kohë t'i çmojnë dhe t'i valorizojnë dhe me të vërtetë janë të pakta në tërë botën. Giulio Berti te ne ka bërë disa ndërtime që janë me të vërtetë fantastike, vila në Pervista ku ka qenë Radio Tirana, lulishtja e ministrive që u shkatërrua kohët e fundit, Shkolla e Mesme në Korçë dhe Pallati i Zogut, i cili ndodhet tek arkivi teknik te Kinema Milenium.

Jam i mendimit se ajo që i ka dhënë qytetari Tiranës është arkitektura italiane dhe jo arkitektura e punës vullnetare, as ndërtimet e sotme, që janë duke u bërë. Kur shoh kullat dhe atë që po bëhet te Gjykata e Lartë, mendoj këtë gjë: në rast se ka ndonjë planet me alienë, alienët duhet të banojnë diku në pallate të tilla. Për mua ajo që i ka vënë vulën bulevardit me ndërtimet e saj, kurrë nuk mund të quhet fashiste, siç e quan kryetari i sotëm i bashkisë. Atëherë hajde të shembim Universitetin, të shembim ministritë, Kryeministrinë dhe pjesë të tjera! Në leksionet e historisë për arkitekturën, të paktën në universitetin ku unë jepja mësim, Universiteti Filips i Marburgut, racionalizmi monumental italian ishte pjesë e programit të fakultetit dhe si ndërtime më të spikatura të tij ishin: Banka Kombëtare, Hotel “Dajti” dhe kompleksi “Skënderbej”, Teatri me pishinat në mes, si dhe Palazzo di Lavoro, që është në Romë dhe pallati i Postës në Palermo.

Fjala “fashiste” për mua nuk hyn fare në këtë mes. Pak muaj më parë në një artikull të botuar në “New Yorker”, i një prej historianeve më me zë të artit, Ruth Bengiat, e kishte titullin “Asnjëherë mos propozoni për të prishur monumentet fashiste, sepse janë shumë të bukura”. Atëherë lind pyetja: pse Teatri qenka fashist dhe Piramida e projektuar si varri i Enver Hoxhës nuk qenka komuniste? Aksi kryesor dhe qendra kryesore historike e Tiranës u shpallën ansambël monumental me VKM-në nr. 180, datë 13.04.2000 me firmën e ministrit të Kulturës së asaj kohe, Edi Rama. Për ta kuptuar se çfarë do të thotë qendër historike, për shembull, tavolina me katër gota verë dhe katër pjata, por thjesht tavolina, të cilën e paguaj unë. Për ta ilustruar po marr rastin e Butrintit. Teatri i Butrintit nuk është monument kulture, Baptisteri nuk është monument kulture, mozaiku nuk është i këtillë dhe as shëtitorja po ashtu. Në vitin 1948, Butrinti u shpall monument kulture dhe automatikisht të tëra monumentet që janë në të janë monumente kulture. Po e njëjta gjë edhe me Teatrin, që nuk ishte monument i veçantë, por element përbërës i ansamblit

monumental. Këtu qëndron hileja në këtë mes. Pra, me VKM-në nr. 325, nr. 12.04.2017, propozuar nga ministrja e Kulturës, Teatri nxirret nga qendra historike dhe lihet në zonën e mbrojtur të qendrës historike, e cila sipas përkufizimit të ligjit synon kalimin gradual në urbanistikën e qytetit. Nuk dua të paragjykoj, por historia nis pikërisht këtu, me propozimin e ministres së Kulturës, e cila më 16.07.2015 shpall monumente të kategorisë së dytë 21 banesa kolektive 6-katëshe, disa me punë vullnetare, dhe më 2017-ën heq në mënyrë të vetëdijshme nga qendra historike Teatrin Kombëtar.

Për aksin kryesor, bulevardin, pa dashur kam qenë një nga aktorët, kur kam qenë drejtori i IMK-së, kryetari i asaj kohe i bashkisë, besoj para 8 vjetësh, u sollën disa briketa ngjyrë vishnje për shtrimin e bulevardit, u kërkua prishja e mozaikut në të cilin ju ecni sot dhe është në formën e luspave të peshkut dhe zëvendësimi i tyre me vija sinusoidale që është para muzeut “Enver Hoxha”. Brenda kompetencave të mia e pata ndaluar këtë proces, e pata dërguar në gjyq, briketat ngjyrë vishnje u kthyen në Itali, afërsisht 1 milion e 200 mijë cope, një radhë komplet dhe zëvendësohen me briketa të hirta, ajo që sot vjen nga kjo kohë. Për dijeni, ministri i Kulturës që e shpalli këtë aks element të qendrës historike të paprekshëm, ishte po kryetari i bashkisë, sepse donte ta ndryshonte këtë. Ky ka qenë një nga argumentet e mia.

Në emisionin që u bë në televizionin “Klan”, për një mosmarrëveshje me drejtuesen e emisionit, problemin e shtrova në drejtim të kujtesës jo historike, por individuale, në kuptimin që i jep Mihail Ende në librin “Fantazia” kësaj kujtese individuale, ku për çdo kërkesë, protagonistin duhej të dorëzonte një nga kujtimet e tij pasi, sipas princeshës së errësirës, po i more kujtimet një njeriu, ai njeri nuk ekziston më. Kjo ka qenë edhe filozofia e Hitlerit që rrafshoi Varshavën. Kështu që sot po i more qytetit arkitekturën, nuk ka më asnjë kujtim. Në fund të emisionit pati një opinion në favor të anës tjetër. Disa shifra të fiksohen në kokë. Nganjëherë duket absurde kjo, por atëherë 876 ishin që bulevardi të ruhej si ka qenë, siç është sot dhe vetëm 120 të bëhej bojë vishnje, si mendonte kryetari i bashkisë.

Personalisht me Teatrin më lidhin kupletet e Ramazan Zyberit, kjo është fëmijëria ime; Hamleti i Naim Frashërit, kjo është rinia ime; interpretimet e Ndrenikës e të tjera. Teatri nuk është një qebaptore që i mban mend vetëm tymin dhe qoftet, por botë shpirtërore ku bashkëjetojnë me aktorin dhimbjet dhe gëzimet. Doja të thosha pa e politizuar: mos e shembni teatrin, sepse do të shembni një pjesë të unit tuaj!

Albana Vokshi – Faleminderit shumë, zoti Barçe.

Fjalën e ka zoti Budina më emër të SASE-s.

Robert Budina- Faleminderit që na mirëpritët!

Ndoqa debatin që bëtë dje! Ju falënderoj që i çuat argumentet deri në fund, të paktën njerëzit kuptuan diçka nga kjo histori. Gjithsecili mban përgjegjësinë e tij publike për ato që thotë. Unë nuk mund të shtoj shumë, sepse ju e keni çuar deri në fund diskutimin dhe të gjitha argumentet kanë dalë. Çdo gjë që unë do të them është mbivendosje mendimesh. Unë do të bëj një thirrje të zhveshur nga çdo lloj ndikimi. Si intelektual nuhas që me miratimin e këtij ligji, ne e çmontojmë veten tonë, prandaj i bëj thirrje maxhorancës që nga ana njerëzore ta shikojnë pak më thellë këtë punë, sepse nuk është kështu. Kjo punë duhet të kishte qenë me e sinqertë që para 20 vjetësh, kur kanë dashur të shembnin Teatrin Kombëtar. Që atëherë jemi dëshmitarë të një gjëje që nuk ka sinqeritet. Këtë e kemi kuptuar të gjithë. Mos kujtoni se e kemi kuptuar vetëm ne, por e kanë kuptuar edhe njerëzit.

Kemi 5 muaj që përpiqemi të komunikojmë, kemi bërë gjithçka, kemi takuar edhe Kryetarin e Kuvendit, edhe zotin President. Kjo lëvizje nga ana jonë është e sinqertë, nuk ka asgjë nga pas.

Ne jemi të bindur që nuk duhet të priset për të gjithë argumentet që ju kanë dhënë juristët, njerëzit e trashëgimisë. Sipas mendimit tim, ju bëni dëgjesa të shpejtuara por, pavarësisht se ju vendosni për Tiranën, duhet të përfshini të gjithë njerëzit. Ju mund të thoni që i keni votat dhe mund të bëni çfarë të doni, por problemi është se, kur ju u morët votat, ne nuk e dinim që do të vinte historia në këtë pikë. Kështu që unë ju ftoj të reflektoni për këtë, sepse nuk po na bëni nder neve, por, së pari do t'i bëni një nder të jashtëzakonshëm vetes suaj.

Kjo është një lëvizje intelektuale që po përpiqet të komunikojë me njerëzit dhe, mbase për herë të parë, ne kemi një reagim nga njerëzit, jo të iniciuar nga partitë. Për këtë më vjen mirë, se kështu ju do të keni mundësinë të vini dhe të flisni me njerëzit e interesuar. Po të ketë sinqeritet, do të ishin bërë vepra të mrekullueshme. Shqipëria ka shumë potenciale që nuk mund errësohen në këtë formë. Nuk mund të merret vendim vetëm pse unë mendoj kështu ose ai mendon ashtu.

Unë nuk dua ta ul diskutimin në nivele që nuk na shkon, dua ta lë në nivele qytetare, prandaj i bëj thirrje ndërgjegjes suaj të reflektoni për këtë që po bëni. Shumë njerëz kanë shkruar, për këtë, nuk do të marr tani të bëj listën, por nuk do t'u heq asnjë presje, sidomos argumenteve që deputet e opozitës kanë nxjerrë. Këtu nuk ka asnjë prapashitesë. Ne ju bëjmë thirrje si qytetarë dhe kam një lloj dëshpërimi personal: na ndihmoni, ngjallni shpresën te njerëzit!

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Jam e sigurt se një pjesë juaja, por edhe një pjesë e artistëve mund t’ia kenë dhënë votën Edi Ramës, sepse pjesë e programit të PS-së ka qenë rikonstruksioni i Teatrit Kombëtar, pra nuk bëhej fjalë fare për teatër të ri.

Apollon Baçi – Jemi të gjithë dakord për një teatër të ri, unë jam i pari. Nëse kjo punë do të kishte qenë e konsultuar me të gjithë ne, të jeni të bindur se biseda nuk do të kishte shkuar fare në këtë pikë. Ne jemi të gjithë për një teatër të ri, sigurisht jo në atë vend, sepse shemben vlerat e trashëgimisë, por mund të kishim diskutuar për një vend tjetër. Mund të na kishit dhënë mundësinë që t’i vinim në ndihmë shtetit nëse nuk i gjente lekët, bënim mekanizmat, meqë ju keni thënë disa herë që ka mungesa në buxhet dhe njerëzit janë nëpër spitale dhe në duhet të kontribuojmë. Por ju bëj edhe një thirrje tjetër: Kultura e bën njeriun. Po e bëjmë njeriun, i kemi bërë edhe spitalet dhe të gjitha. Po të jemi të ndërgjegjshëm dhe të vetëdijshëm, sigurisht që mund të bëjmë edhe një shtet shumë të mire. Ju këtë e keni anashkaluar për shumë vjet. Tani ka ardhur momenti që të kuptoni se cili është roli i vërtetë i kulturës dhe sa mund të ndihmojë ajo. Me vetëdijen tonë ne nuk kemi nevojë të jemi numra, se ne jemi njerëz.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Jam e sigurt se të gjithë ne që jemi këtu, por dhe të gjithë shqiptarët brenda dhe jashtë shtetit, do të jenë të gatshëm dhe në gjendje për të kontribuar, nëse u jepet kjo mundësi për të ruajtur Teatrin Kombëtar, për të ruajtur qendrën historike të Tiranës, e cila po vidhet dhe po i jepet një privati, si dhe për të kontribuar edhe në ngritjen e një teatri tjetër të ri në një vend tjetër.

Po e jap fjalën sipas radhës.

Fjala për zonjën Elsa Demo.

Elsa Demo – Mirëdita!

Faleminderit për këtë mundësi të vonuar për të dëgjuar edhe ata, të cilët, prej muajit shkurt, vazhdojnë të protestojnë në oborrin e Teatrit Kombëtar dhe dita ditës po bëhen edhe më të shumtë! Për herë të parë kemi të bëjmë me një absurditet lumturisht të bukur që po ndodh në Teatrin Kombëtar, që nuk janë artistët ata që po e mbrojnë Teatrin Kombëtar, Robert, mos më keqkupto, por keni mbetur një dorë shumë e vogël, janë njerëzit që po e mbrojnë dhe kjo duhet të na lumturojë të gjithëve. Ju nuk keni kaluar aty afër për të parë se si njerëzit, ndërsa nisen për të bërë punët e

tyre të zakonshme, ndalojnë me biçikletë, firmosin, japin numrin e kartës së identitetit dhe largohen. Disa rikthehen aty përditë, por ju nuk mund ta shihni këtë gjë, përderisa nuk jeni aty. Para një jave, kur binte ai shiu i tmerrshëm, njerëzit me çadra nuk lëviznin dhe kur u dha sinjali se projektligji do të kalojë në parlament, të gjithë panë se si u dridhej mjekra, se si u dridhej zëri, se si qanin së brendshmi e së jashtmi për atë objekt. Por ju nuk mund ta kuptoni këtë gjë, sepse unë nuk e kam parë asnjërin prej jush aty, as këtë zotërinë këtu që vazhdon të luajë me celular, nuk e kam parë aty.

Unë e di që këtu ka njerëz shumë të kulturuar, i kam përballë, ata e dinë se çfarë është ligji, se cila është vlera e Bibliotekës Kombëtare, se çfarë është teatri, se sa antivlera ka prodhuar ai teatër dhe se sa vlera janë varrosur aty. Pikërisht ato vlera ne duhet t'i përdorim sot si shkallë dhe të tejkalojmë antivlerat.

Gjatë gjithë këtyre ditëve janë sensibilizuar njerëz, që deri dje kanë qenë të fjetur dhe janë zgjuar pikërisht nga ata që janë sot në shesh dhe nëse ka një arritje të madhe është kjo, njerëzit kanë filluar të zgjohen, edhe ata që janë të dëshpëruar dhe mendojnë se ai teatër do të shembet, kanë filluar të zgjohen dhe kjo duhet të na lumturojë dhe të na bëjë të shpresojmë dhe duke qenë në dëshpërim. Kemi parë se si zoti Plasari, një njohës shumë i mirë i vlerave të Tiranës dhe të kombit, ka shkruar një artikull të mrekullueshëm dhe ka argumentuar që kemi të bëjmë me një mentalitet të mykur të ministres Kumbaro, zotit Veliaj dhe gjithë shpurës së tyre nga pas, të cilët për hir të një rroge, duhet t'i mbështesin dhe të dalin sot në front, në një front kundërshtar, në një llogore të panevojshme.

Zoti Baçe argumentoi mjaft mirë për vlerat arkitekturore, por ne nuk duhet të harrojmë se aty janë fillesat e teatrit profesionist, jo të teatrit të Shkodrës, nga vjen zotëria, i cili e ka kaluar 100-vjeçarin e historisë së teatrit. Aty kemi fillesat e Akademisë së Shkencave, kemi Çabejin, kemi Mahir Domin, kemi me dhjetëra intelektualë që sot nuk jetojnë dhe për hir të kujtimit të tyre ne duhet ta mbrojmë këtë godinë. Si gazetarë e kulturës prej 20 vjetësh shkoj aty çdo fundjavë për të parë një shfaqje teatri, natyrisht kur ka, sepse kjo qeveri e ka zhdukur edhe prodhimin teatror, tjetër gjë se çfarë propagandon. Nuk kanë arritur në një pikë të tillë vlerat e teatrit, si teatër them, jo si objekt. Kam 20 vjet që hyj e dal aty dhe e kam objekt të punës sime atë teatër; kam bërë reportazhe për të denoncuar pikërisht shkatërrimin e ngadaltë të atij teatri, por me shpresën që do të dëgjohem dhe do të rindërtohet, jo të shembet. Profesionistët dhe arkitektët e vërtetë kanë demonstruar, jo ata që janë nëpër universitete, bashki apo nëpër institutet e projekteve të ndërtimit. Arkitektë të

pavarur, me zërin e tyre të pavarur, kanë argumentuar se ajo godinë mund të rripet e gjitha dhe të ribëhet nga e para.

Nëse ai objekt do të ketë atë fund që ju keni paralajmëruar, do t'i vijë radha gjithë ansamblit rreth e rrotull, sepse ai objekt ka një martesë të shkëlqyer deri tani me objektet rreth e rrotull.

Nuk mund ta bëni këtë gjë! Në emër të cilit zhvillim?! Më thoni, çfarë zhvillimi do të sjellin kullat?!

Ju jeni të paduruar, ndërsa kultura është e avashtë, sepse kultura punon ngadalë. Prandaj ju, teksa shihni frytet, menjëherë thoni se nuk na duhet.

Ju lutem, mos e shembni atë teatër!

Nëse nuk i keni çuar ndonjëherë fëmijët tuaj në teatër, bëjeni! Para se të votoni, pyetini fëmijët tuaj, a e duan ata këtë gjë?

Pyetini fëmijët tuaj, a kanë shkuar ndonjëherë në Bibliotekën Kombëtare? Se mbase nuk e dini se çfarë bëjnë fëmijët tuaj dhe çfarë dëshirash mund të kenë ata.

Unë kam parë salla teatri në Poloni. Kam parë salla teatri në Vroclav, që para 5 vjetësh ka qenë një nga qendrat e kulturës të Europës kulturore, atë që do të bëjë kryetari i bashkisë. Kam parë sallën e Jerzhi Grotovskit, një nga njerëzit më influentë të teatrit të shekullit të XX, që punoi në kushte të izoluara në Europën Lindore dhe ajo sallë ruhet për mrekulli së jashtmi dhe brenda është modernizuar në mënyrë të shkëlqyer.

Pra, përse doni të modernizoni brenda dhe jashtë? Përse doni të çrrënjosni në këtë mënyrë?

Ju lutem, mos e shembni atë objekt!

Ju lutem, matuni para se të votoni!

Faleminderit!

(Duartrokitje në sallë.)

Albana Vokshi – Elsa, të falënderoj për mesazhin e ndier!

Shpresoj shumë që të jetë një thirrje e brendshme juaja, që sadopak të prekë ndjenjat apo vlerat që mund të ketë, dhe jam e sigurt që ka, edhe ndër deputetët e maxhorancës. Sigurisht, edhe për t'u bërë thirrje të gjithë qytetarëve që po na ndjekin, sepse kjo ishte edhe arsyeja që ne vendosëm ta organizojmë këtë dëgjese, me atë pak kohë që na kishin lënë, për t'u sensibilizuar për krimin e madh që po i bëhet Tiranës, duke u bërë thirrje edhe familjarëve tanë, vëllezërve, motrave, kushërinjve, prindërve, të dalin, që jo vetëm të firmosin, por edhe të rezistojnë. Të rezistojnë për

të mbrojtur Tiranën tonë, të rezistojnë për të mbrojtur vlerat historike, kulturore dhe artistike, pra trashëgiminë kulturore.

Të falënderoj edhe një herë për mesazhin!

Jorida Tabaku – Për procedurë...

Albana Vokshi – Po.

Jorida Tabaku – Do t'u kërkoja kolegëve socialistë, se ne më njëri-tjetrin jemi mësuar që çfarë fjalësh nuk themi, të paktën të kenë respekt për të ftuarit që kanë ardhur këtu. E kuptoj që shumë nga ju janë bezdisur. Jeni të gjithë me kokë ulur, me celularë nëpër duar, por nëse keni diçka, nëse doni të shfryni mllefin, na u drejtoni neve, mos iu drejtoni të ftuarve. Ata kanë ardhur këtu, po shpenzojnë kohën e tyre. Ne jemi të paguar këtu, ata nuk janë të paguar.

Albana Vokshi – Faleminderit!

Zoti Angjeli, keni fjalën.

Sokol Angjeli – Ju falënderoj që më dhatë mundësinë të bisedoj me ju! E quaj veten të privilegjuar në këtë sallë sot.

Dua të tërheq vëmendjen tuaj për 2-3 gjëra të vogla, të vogla për ju, se për ne janë jetësore dhe fundamentale.

Ju thoni se do të shembim Teatrin Kombëtar. Nuk po shembni një teatër, por po shembni 2 teatro, sepse është Teatri Kombëtar i Dramës dhe i Komedisë, është edhe Teatri Eksperimental “Kujtim Spahivogli”. Pra, me një rruspë, me një buldozer, ju do të shembni dy teatro. Qëllimisht nuk thuhet se do të shemben dy teatro, por thuhet: “Po shembim vetëm Teatrin Kombëtar.”

Teatri Eksperimental është një qendër shumë e rëndësishme për aktorët e rinj, regjisorët e rinj, skenografët e rinj dhe për të gjithë njerëzit e teatrit, të letërsisë dhe të arteve.

Së dyti, ju flisni për një UEFA, se në qoftë se do të vinte, ne do të turpëroheshim për këtë “UEFA-n e teatrove”. Zotëri, ne kemi qenë në UEFA-n e teatrove, kemi qenë në Unionin e Teatrove Kombëtare të Europës.

Personalisht, kam luajtur në Globe Theatre dy net, në teatrin më të magjishëm të botës, sepse ne ishim pjesë e Unionit të Teatrove dhe kemi 4 vjet, zoti Velaj duhet ta dijë shumë mire, që nuk jemi më pjesë e Unionit të Teatrove Kombëtare. Pra, ne dolëm nga unioni me dëshirën tonë, sepse nuk duam të jemi pjesë e UEFA-s së teatrit.

Pra, mos vajtoni atë që keni bërë vetë! Ju e keni bërë vetë këtë. Ju vetë na keni nxjerrë nga UEFA e teatrit.

Së treti, gjurma e teatrove, e Teatrit Kombëtar dhe e Tetarit Eksperimental, është 8 mijë e ca metra, domethënë, është një drejtkëndësh me 8 mijë e ca metra katrorë, kurse gjurma e tetarit të ri kombëtar që do të bëhet, është diku te 1500-2000 metra. Ndërkohë ju deklaroni se asnjë centimetër e sipërfaqes së Teatrit Kombëtar nuk do të cenohet. Sigurisht që këtu ka një mospërputhje të madhe midis këtij drejtkëndëshi të madh me sipërfaqe prej 8000 metrash dhe këtij drejtkëndëshi që doni të bëni ju me një sipërfaqe prej 2000 metrash. Nëse ju do të mblidhni sipërfaqen e katit të parë, me atë të katit të dytë, me atë të katit tretë, me sipërfaqen e tarracës, me sipërfaqen e katit të parë dhe të dytë të nëntokës, atëherë po, ju mund ta bëni aq sa është sipërfaqja aktuale e dy teatrove, sepse ju po shembni dy teatro dhe jo një, të nderuar deputetë. Po, ju mund ta bëni, por kjo nuk është e njëjta gjë. Pra, ju lutem, mos e mashtroni opinionin publik, bëhuni burra dhe gra të forta dhe tregojeni të vërtetën, që ne do t'ju marrim artistëve një sipërfaqe prej 8000 metrash katrorë dhe do t'ju japim një godinë me 2000 metra katrorë në maksimumin e saj.

Faleminderit për dëgjesën!

Albana Vokshi – Faleminderit, Sokol!

Në fakt, ne e kemi kërkuar edhe dje dhe vazhdojmë ta kërkojmë edhe sot projektin e propozuar nga kompania, i cili nuk bëhet publik dhe nuk na vihet në dispozicion nga ministria. Ne sot po diskutojmë për një projektligj pa ditur se cili është plani. Vetëm na është thënë që do të ngrihet një grup negociator me në krye kryetarin e Bashkisë, i cili mund të negociojë, mund të japë tokën, mund ta tjetërsojë dhe mund të bëjë çfarë të dojë. Pra, mendojeni sikur kjo të ndodhte në një vend tjetër demokratik, në një republikë parlamentare, ku ne si komision kemi kaq kohë që kërkojmë projektin dhe nuk na vihet në dispozicion. Ne nuk e dimë se sa kulla do të ndërtohen. Nëse vendosim projektin, që ka publikuar “Bigu”, mbi hartën hipotekore të teatrit, tri kullat përfshihen brenda sipërfaqes së teatrit. Kjo shikohet shumë lehtë dhe nuk është përgënjeshtuar. Pra, askush nuk na thotë se sa është dhe cila është sipërfaqja. Ne i kemi kërkuar edhe mbrëmë, edhe sot Ministrisë së Kulturës t'u dorëzonte deputetëve projektin e propozuar, mbi të cilin do të bëhen negociatat për kontratën e re, por shpresoj që përfaqësuesit e Ministrisë së Kulturës t'i kenë sjellë të paktën dorazi, sepse me *e-mail* edhe sot ua kujtuam, por nuk na e sollën.

Ky është diskutimi i fundit për këtë dëgjesë. Ju thashë që do të ketë dëgjesë edhe rreth orës 16:00 pasdite te Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese.

Fjalën e ka zonja Enida Bozheku.

Enida Bozhegu – Përshëndetje! Unë jam Enida Bozheku dhe jam avokate e qytetit të Tiranës, por edhe e qytetit të Romës. Kam studiuar dhe jam formuar në vendin e lashtësisë, në vendin e trashëgimisë kulturore *par excellence*, ose më saktë në atë vend në të cilin ligji i ri i trashëgimisë kulturore, pra ligji numër 27, për të gjithë ata që nuk e dinë, ka hyrë në fuqi me datë 27 qershor të vitit 2018 dhe që sot legjitimisht është i vetmi që mund të rregullojë, disiplinojë dhe menaxhojë gjithçka që ndodh me këto objekte, të cila pavarësisht se nuk e kanë statusin e trashëgimisë kulturore, duhet t’i përmbahen asaj. E thënë ndryshe dhe shkurt, projektligji në fjalë automatikisht dhe ligjërisht ka rënë, për një arsye shumë të thjeshtë, mjafton të lexojmë nenin në të cilin thuhet: “Për sa i përket trashëgimisë kulturore, Ministria e Kulturës ose entet ku do të ndërtohet një ent, pra që ka 12 muaj kohë për t’u ngritur, do të menaxhohet me buxhet publik, gjithçka që lidhet me ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore”. Pra, ndalohej me ligj partneriteti publik privat, këtë duhet ta keni të qartë; e thotë ligji i ri nuk e them unë. Gjithashtu, ligji i ri u atribuon të gjithë atyre personave që kanë dëshirë, për financimin publik, të thonë fjalën e tyre si filantropë. Nëse e konsiderojnë veten të tillë, mund ta bëjnë vetëm në rast sponsorizimi dhe donacioni, por asnjëherë me partneritet publik privat, që do të thotë, shteti nuk mundet në asnjë lloj forme dhe mënyre të kthehet në garant për investimin e bërë nga privati. Pra, në fillim duhet të jemi të qartë me ligjin dhe pastaj të flasim.

Për sa i përket pjesës teknike, këtu mendoj që jam mes subjekteve, mes individëve, mes deputetëve dhe zotërinjve dhe unë marr përgjegjësinë mbi shpatulla dhe them: po, përfaqësoj popullin shqiptar, atë pjesë që mendon dhe logjikon si ne që duam kulturën, duam trashëgiminë dhe vlerat që ju përfaqësoni zërin tonë nga ana e ligjore, ligjshmërinë, sepse ju jeni ligjvënës dhe ju vendosni. E thënë ndryshe, për sa i përket këtij ligji, duke lexuar relacionin e zonjës Kumbaro dhe ministrisë së saj, sinqerisht vërej shumë mangësi teknike juridike, që për një jurist është e frikshme. Nuk e di se kush e ka bërë, por mendoj se duhet të dorëzojë diplomën kushdo që e ka bërë, për vetë faktin që kontradiktat që mbart në vetvete ky relacion, janë aq të fuqishme dhe aq të thella, sa dhe një jurist, i sapodalë nga shkolla, do t’i kuptonte. Pra, nga njëra anë thuhet që për teatrin është miratuar rikonstruktimi në përputhje me programin e qeverisë shqiptare, të maxhorancës së sotme, sikurse e përmendi edhe zonja Vokshi. A e dini se çfarë do të thotë “rikonstruktim”? Rikonstruktim do të thotë: ribërje, riqasje dhe rijetësim. Ligji i ri i trashëgimisë kulturore flet për rijetësimin.

Ftoj të gjithë anëtarët e këtij komisioni dhe anëtarët e të gjitha komisioneve parlamentare të Republikës së Shqipërisë që të gjejnë vetëm një fjalë, që lidhet me shembjen në ligjin që ka hyrë në fuqi, i cili është i vetmi ligj që ne i përgjigjemi dhe nuk ka të dytë! Ndaj, është e kotë që flasim për këtë projektligj, i cili nuk duhej të propozohej fare, pasi bie në kundërshtim me ligjin aktual. Pra, ky projektligj bie në kundërshtim me ligjin funksional të posaçëm, që është ligji për trashëgiminë kulturore, i cili ka nene specifike, që rregullojnë mënyrën se si bëhet financimi, ku i hiqet e drejta çdo privati që të mund të tjetërsojë apo të përvetësojë pronën publike në të cilën ka trashëgimi kulturore. Në këto nene përcaktohen disa prona publike si trashëgimi shpirtërore, historike, artistike, materiale dhe jomateriale. Tek Teatri Kombëtar kemi të bëjmë me një godinë historike.

Unë ftoj të gjithë arkitektët italianë, më falni që po i drejtohem Italisë këtë herë, por janë ata që e kanë ndërtuar dhe e dinë se çfarë do të thotë materializmi fashist, sepse ata e kanë rivlerësuar. Unë do t'ju jap një shembull konkret: në mes të Romës (besoj se të gjithë ju e keni pasur mundësinë për të shkuar atje, por po flas për ata shqiptarë, të cilët nuk kanë pasur mundësi që ta shkojnë) në stadiumin olimpiq, i cili është ndërtuar gjatë periudhës së fashizmit, ku zhvilloheshin lojërat olimpike, është një obelisk, në të cilin është shkruar me germa të mëdha: “Musolini”. Në vitin 2006 ka pasur një debat shumë të fortë në Itali, sepse jo vetëm në Shqipëri është rebusi i këtyre problemeve, nëse duhej apo nuk duhej shuar emri i Musolinit nga obelisku, që e shikonte e gjithë Italia dhe kushdo që shkonte në Romë, sepse Roma është një qytet artistik kudo që shkel. Debati doli në përfundimin se nuk duhej hequr, sepse ajo përfaqësonte një periudhë historike, përfaqësonte memorien historike. E njëjta gjë ndodh edhe me Teatrin Kombëtar, i cili përfaqëson memorien tonë. Unë nuk e di sa nga ju kanë lindur dhe janë rritur në Tiranë, nuk e di sa nga ju e njohin historinë e këtij qyteti në themele, nuk e di sa nga ju kanë lidhje shpirtërore me këtë qytet, i cili, çdo ditë e më shumë (të gjithë ata që jetojnë jashtë, që ikin dhe vijnë e shikojnë) po modernizohet. Ne jemi shumë të lumtur për këtë, ju falënderojmë për këtë, sepse ne duam që Tirana të modernizohet, por duam që Tirana të jetë edhe një vend me një memorie dhe një trashëgimi historike. Edhe ne duam që t'u mburremi miqve tanë të huaj, që të mos na tregojnë ata Koloseun, të mos na tregojnë ata Versajën, të mos na tregojnë “Pallatin e Dimrit” në Moskë, që edhe ne të kemi se çfarë t'u tregojmë.

Teatri Kombëtar është 80 vjeç dhe pas 20 vjetësh ai bën 100 vjeç dhe atëherë asnjëri nuk do të guxojë ta prekë, sepse kështu është ligji. Prandaj, në radhë të parë, ne duhet të respektojmë

ligjin, sepse në qoftë se nuk e njohim ligjin, në qoftë se nuk do të arrijmë të kuptojmë, të interpretojmë dhe të respektojmë vlerat që ne mbartim, atëherë ne do të jemi komplet në një derivë për të cilin do të vendosë një njeri apo 5 numra maxhoritarë. Unë e kuptoj se ka njerëz që qeshin, ndoshta edhe ndonjë mik i familjes, që fatkeqësisht ose fatmirësisht qesh me këtë që unë po them, por nuk ka problem. Ata mund të qeshin, sepse, në fund të fundit, ne po bëjmë një aktrim këtu. “Jemi të gjithë protagonistë të skenës së jetës”, thoshte Shekspiri. Ne jemi aktorë dhe këtë herë po bëjmë aktrimin më të shëmtuar, sepse po aktrojmë me vlerat tona, po aktroni ju, po aktrojmë edhe ne me fëmijët tanë.

Teatri Kombëtar nuk duhet shembur, sepse mbart vlera, por, mbi të gjitha, është në shkelje të hapur me Kushtetutën dhe me ligjin e ri për trashëgiminë kulturore. Për këtë gjë ne kemi bërë një petition, që po firmoset nga mijëra e mijëra qytetarë, jo thjesht nga qytetarë në kuptimin e gjerë të fjalës, por nga intelektualë të vërtetë, jo ata me diploma të blera.

Faleminderit!

Albana Vokshi- Faleminderit, zonja Enida!

Në fakt, ligji që ju sapo përmendët ka kaluar me shumë nxitim nga maxhoranca edhe në shkelje të procedurës parlamentare. Ky është rasti ku mund të respektohej, por ai po shkelet. Ky nuk është ligji i vetëm që po shkelet, sepse me anë të këtij projektligji, minimalisht po shkelen 3-4 ligje të tjera dhe një sërë nenesh të Kushtetutës. Pra, praktikisht ky është një ligj antikushtetues, i cili nuk duhet të kishte ardhur fare, sepse, nëpërmjet këtij ligji po ligjërohet një vjedhje e madhe e qendrës historike të Tiranës. Gjithsesi, ne këtu do ta ndërpresim pjesën e dëgjësave për të vazhduar me diskutimin nen për nen.

Dua të qartësoj edhe një herë qëndrimin e Partisë Demokratike...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

A keni pyetje? Në rregull, në qoftë se keni pyetje, atëherë do t’i dëgjojmë. Më pas do të vazhdojmë me diskutimin nen për nen.

Luçiano Boçi – Faleminderit!

Së pari, dua të falënderoj profesorin, i cili na solli argumente profesionale! Gjithashtu, dua të falënderoj zonjën Demo, e cila na solli një pjesë të teatrit, efektin katarsik, për të cilin ne të gjithë flasim, por, në fakt, nuk e përjetojmë shumë! Ajo që ju kërkua këtu, lidhur me spastrimin shpirtëror dhe reflektimin ndaj këtij ligji, ishte shumë e drejtë. Falënderoj edhe Sokolin, që na solli pjesën dhe frymën e “Globus-it”!

Zoti Sokol, unë jam dakord me ty, sepse nuk është njëloj sikur të luash në Teatrin Kombëtar dhe të luash në një teatër si Turbina, sepse edhe emocionet janë të ndryshme, jo më pastaj diferenca ndërmjet “Turbinës” dhe “Globus”-it”, që është edhe më e madhe. Falënderoj zotin Budina për argumentet që solli dhe zonjën Bozhegu për argumentet juridike!

Duke u ngacmuar nga fjala juaj pyetjen e kam për zotin Baçe dhe zonjën Bozhegu, sepse mospërputhja dhe kontradiktat ligjore janë të mëdha me ligjin, sikurse ju e thatë, por janë në kundërshtim edhe me VKM-në nr. 325, që e përmendi edhe profesor Baçe, VKM-ja nr. 325, që ishte atentati ndaj Teatrit Kombëtar, duke e hequr nga qendra historike Ansambël Monument Kulture dhe duke e spostuar në zonën e mbrojtur. Nga përkufizimi që ka sot zona mbrojtëse ose “zona e mbrojtur”, ka edhe diferenca midis këtyre termave në ligjin aktual dhe nga trajtimi që i bëhet në VKM-në nr.325, përcaktohet se në zonën e mbrojtur mund të bëhet ndërtim, por me studim të posaçëm dhe ky ndërtim ka disa parametra dhe rregulla të caktuara.

Profesori e tha: “Zona e mbrojtur është vazhdim normal logjik arkitekturor i zonës historike dhe duhet të ruajë këto parametra dhe ta mbështesë atë”.

Pyetja ime është: Brenda dy akteve ligjore, ligjit dhe VKM-së, pse nuk pranohet shkatërrimi, se nuk flitet për prishje, pra edhe një herë, është zonë historike, nuk përmendet shkatërrimi? Sepse maxhoranca për të qenë në rregull, ka vendosur që në zonën e mbrojtur mund të bëhet një ndërtim dhe lartësia e këtij ndërtimi mund të matet me ndërtesën më të lartë të qendrës historike.

Fatkeqësisht, qendra historike është transformuar dhe ndërtesa më e lartë është kulla e stadiumit kombëtar, kështu që lartësitë e kullave që do të bëhen pranë Teatrit Kombëtar do të jenë në lartësinë e kullës së stadiumit kombëtar.

Kam edhe pyetjen tjetër për ju si specialist, zoti Baçe. Zona e mbrojtur duhet të suportojë zonën historike, s’duhet t’i zërë as dritën, as frymën, as rrjetin rrugor. Pra, sipas jush, a lejohen ndërtime kaq të larta në një zonë historike, aq më tepër që s’duhet të harrojmë se jemi në perimetrin e objekteve monument kulture? Janë Sarajet e Toptanasve dhe kështjella mesjetare e Tiranës, që është pothuajse në gjysmën e saj e shkatërruar.

Si specialist, a mendoni se mund të vihet dorë dhe të ndërtohen objekte të reja brenda këtij territori me lartësinë që i zë frymën, dritën, pamjen objekteve historike?

A lejohet shkatërrimi, sepse nuk përmendet? Pengohet shkatërrimi, është zonë e mbrojtur, që do të thotë se nuk shkatërrohet? A mund të ndërtohet, por në harmoni me të gjithë strukturën dhe ansamblin që është aty?

Këto janë dy pyetjet e mia.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Urdhëroni, zoti Baçe!

Apollon Baçe – Ky transformim është shumë obskur. Unë kam pyetur edhe kolegët dhe iniciativa duhej të dilte nga Instituti i Monumenteve, por ata që janë anëtarë të këshillit shkencor thonë se nuk e dinë si u bë kjo punë. Më duket se ky është një cirkuit shumë i shkurtër i drejtores së Institutit të Monumenteve me ministren.

Nëse një apo dy vjet më parë është menduar të priset ky teatër, fillon e gërmohet baza ligjore, që do të thotë se nuk është ana fizike e monumentit, qenka në gjendje të keqe apo të mirë.

Për sa i përket kalimit, kuptohet se zona e mbrojtur kërkon të sjellë një harmonizim midis qendrës historike dhe pjesës tjetër të qytetit, atëherë do të thotë se gjithnjë ka një rregull të tillë që nga fusha kalohet në kodër dhe pastaj kalohet në male, kurse këtu kemi kalimin nga fusha në male pastaj fillojnë kodrat. Pa dyshim që nuk mund të quhet absolutisht zonë e mbrojtur, nëse fillojnë të ngrihen kulla, të cilat e tjetërsojnë këtë zonë.

Ajo që ka tepër rëndësi në arkitekturë, në urbanistikë, është rakursi, do të thotë mënyra si ti mund ta shohësh në plan diçka. Ajo është një kuti, po ama ajo kutia, për shembull, ajo kulla që është bërë te Gjykata e Lartë, qëndron në mënyrë të tmerrshme në krahasim me Bankën Kombëtare dhe shkatërron komplet pamjen e saj. Pra, ne nuk kemi absolutisht një studim të kësaj zone. Vetë ligji, për mua, është i formuluar dobët dhe është shumë tendencioz.

Albana Vokshi - Faleminderit!

Urdhëroni, Jorida!

Jorida Tabaku – Edhe unë dua t’ju falënderoj për prezantimin!

Në fakt, unë isha ditën e diel atje, se kishim vendosur t’ju linim ju në protestën tuaj qytetare deri në momentin, kur më 8 qershor, ky u bë public, u bë një projektligj dhe doli për konsultim.

Në momentin që u depozitua në parlament, e para zonja Vokshi, por edhe të tjerë, unë isha me profesor Gurakuqin atë ditë, janë bërë pjesë e protestës suaj, që ishte me të vërtetë protestë qytetare dhe unë aty pashë të rinj, pashë nëna me fëmijë, pashë familje që vinin, ashtu siç tha zonja Demo, ndalonin aty.

Këto kohë edhe ne kemi filluar të lexojmë për teatrin, jo se jemi detyruar, por me kënaqësi kemi filluar të investigojmë dhe të lexojmë më shumë, dhe unë lexova Montanelin, i cili qysh në vitin 1939 thoshte se Tirana është kthyer në një qytet me të tashme dhe të ardhme, pa të shkuar. Kjo po i ndodh Tiranës edhe sot. Faktikisht, pas 90 vjetësh po ndodh përsëri e njëjta gjë me Tiranën, dhe është fatkeqësi.

Unë kisha dy pyetje. E para, lidhet me pedonalen dhe kompleksin që e shoqëron atë. Sipas projektit që kemi parë, propozohet të kthehet në një rrugë. Është një projekt i BE-së me 5 milionë euro që do të ikin, por qeveria s'po pyet fare për investimet si të shtetit, ashtu edhe për donacionet private.

A është e mbrojtur pjesa e pedonales dhe institucionet e tjera që janë aty?

Së dyti, a ka pasur dëgjesa me artistët për këtë ligj? Ligji u bë fakt i kryer dhe u miratua menjëherë në mbledhje qeverie, u depozitua menjëherë dhe u fut me procedurë të përshpejtuar. Një ligj me një interes të tillë besoj se do të ngjallte shumë interes edhe për komunitetin tuaj, që të diskutojë dhe të debatojë gjatë.

Nuk ndodh në Shqipëri, të paktën nuk ka ndodhur në këto 100 vjet, që të prishet një ndërtesë e tillë pa pasur debat dhe pa pasur diskutime. Ne jemi bërë me dije vetëm për takimet që kryetari i bashkisë ka bërë me disa artistë, që, fatmirësisht, unë kam këtu edhe fjalën që ai ua kishte shpërndarë deputetëve socialistë, se ai ishte duke aktruar atje, siç po aktron kohët e fundit. Kishte mësuar përmendësh disa gjëra që ka një muaj që i përsërit, por akoma nuk e kemi thelbin dhe akoma nuk e kemi fjalën tuaj për projektin dhe ligjin. A ka pasur dëgjesa me komunitetin tuaj?

Apollon Baçi – Po i përgjigjem pyetjes së parë. Në lidhje me pedonalen, që do të thotë se nga një anë ka atë që quhet Kalaja e Tiranës. Në fillim janë ato rrënojat, pastaj është muri vertikal te kinema Mileniumi. I gjithë krahu i djathtë i saj është monument kulture. Në anën tjetër kemi teatrin, të cilin po mundohen ta heqin, që të bëjnë atë që do të bëjnë.

Pastaj, më tutje, vjen Akademia, që prapë është një monument kulture. E gjithë zona aty, pa dyshim që nuk është qendër e mbrojtur, por është qendër historike e qytetit. Ky është nukli i qytetit, nga i cili ka dalë qyteti. Qyteti është xhamia e Ethem Beut dhe kjo shtrirja në këtë zonën këndeje. Ne po hamë zemrën e qytetit, nuk po bëjmë gjë tjetër.

Unë do të thosha këtë: kur kam qenë në Kanada, në Otava, të gjitha ndërtesat ishin drejtkëndëshe. Ambasada amerikane do të bëhej me një harkim fare të lehtë, një tre-katër metra, pra një harkim shumë i vogël. Qytetarët u ngritën kundër, aq sa u bë referendum për këtë. Me një

fjalë, u pyet populli për këtë gjë, nuk u pyet një parti apo një tjetër, por secili shprehu mendimin e vet.

Mua ma ha mendja që, në rast se ka filluar një fushatë e këtillë, që të mblidhen firmat, tekefundit referendumi vetëm 50 mijë vetë do, që të miratohet. Le të bëhet dhe ta thotë populli: e dua, s'e dua; dua ta shemb e dua të ndërtoj një Tiranë komplet tjetër. Të vijmë e të banojmë në një qytet, ku s'kemi qenë ndonjëherë.

Albana Vokshi – Po, zoti Budina!

Robert Budina – Faleminderit për pyetjen.

Kemi pesë muaj që rrimë. I kemi kërkuar ministres së Kulturës, që të vinte e të fliste me ne. Nuk erdhi. Bëri diversion, duke thërritur disa artistë të veçantë, në njëfarë kuptimi për të na përçarë, por nuk erdhi që t'u përgjigjej pyetjeve që ne i drejtonim.

Kjo ishte për punën e ligjit fillimisht, pastaj doli edhe puna e teatrit. Ne nuk jemi një grup i organizuar, i strukturuar, por jemi disa qytetarë, intelektualë, me një ndërgjegje të caktuar, që mendojmë se kjo nuk duhet të prishet.

Gjatë kësaj përpjekjes sonë, na u afruan shumë intelektualë, i pari profesor Apolloni, meqë është edhe këtu, kenë lexuar gazetën, por ishin edhe Rubens Shima, Aurel Plasari, Elsa Demo. Nuk shkuam ne t'u thoshim, por e ndjenë dhe erdhën vetë. Pra, ne vetvetiu u bëmë një grup shumë i madh, dhe kuptuam se ky mendim intelektual nuk ishte fare i përfaqësuar në dëgjuesat që bënte zoti Veliaj. Afruam edhe juristë, të cilët na shpjeguan se zoti Veliaj nuk ishte negociatori. Se ne u detyruam të bëheshim edhe juristë. Këta njerëz na shpjeguan se këtu ka një gjë që nuk shkon. Atëherë ne filluam t'i ftonim njerëzit, kërkuam të bënim dëgjesa. Zoti Veliaj, sipas mendimit të shumë juristëve me të cilët jemi konsultuar, nuk e kishte të drejtën të bënte negociata me ne, sepse ligji nuk ia lejonte, por erdhi ai dhe e bëri, jo ministrja e Kulturës. Ky fakt na ngjalli një dyshim tjetër. Kemi kërkuar vazhdimisht që të jemi prezentë në këto dëgjesa, që të japim mendimin tonë, jo personal, por kush e merr përsipër, që ka përgjegjësi dhe eksperiencë, të thotë mendimin e tij. Kjo nuk na u lejua. Për këtë arsye ne ndenjëm në teatër. Kur kuptuam se nuk kishim asnjë mbështetje, ne vendosëm të rrinim aty. Po ju them diçka: ne artistët kemi bërë brenda nesh një katarsis. Shumë prej nesh kanë ikur në punën e tyre, por gjetëm momentin të bashkoheshim, sepse na bashkon diçka. E kuptuam se të gjithë mbetëm artistë, nuk bëmë asgjë në këtë jetë, sepse nuk patëm mundësi. Mund të kishim bërë shumë më tepër, desha të thosha. U bashkuam, sepse na bashkoi teatri, na bashkoi një vetëdije. U bashkuan shumë njerëz. Filloi si një shaka. Ne ishim çdo

javë aty dhe na vinin pesëdhjetë veta, por me sa duket ata pesëdhjetë vetë a njëqind vetë që vinin ishin shumë cilësorë, sepse ishin ata që na sollën edhe të tjerë. Nuk donim të përfshihej politika në këtë punë. Kemi vuajtur shumë, megjithëse e dimë mirë se pa mjete politike kjo punë nuk bëhet. Kur ju bëtë ligjin, na u hoq e gjithë e drejta për të qenë të papolitizuar. Në këtë moment ne jemi të detyruar ta thërrasim politikën, sepse nuk kemi mjete ligjore të mbrohem. Kështu, unë ftoj deputetët e opozitës, që t'i shkojnë deri në fund kësaj pune, sepse e shoh se do ta keni shumë të vështirë, se keni betejë tjetër.

Kjo ishte arsyeja se përse ne kaluam deri në këtë pikë, hap pas hapi. Të jeni të bindur se të gjithë njerëzit që janë aty, nuk kanë absolutisht asnjë inat. Janë njerëz që duan të vërtetën, janë njerëz, të cilët duan që ajo pronë të mos priset sot. Tri gra nga Fieri na ndaluan në rrugë duke qarë: ju lutemi, mbrojeni! Ju lutemi, mbrojeni! Nuk ka kuptim të shembet!

Ishin gra të moshuara. Kishin ardhur në teatër. Vinë dhe ndjekin teatrin. Ju nuk e besoni, por ka njerëz që vijnë nga rrethet për të parë një shfaqje teatri, pavarësisht se Kryeministri thotë se duhet të shohim një çikë cilësinë e shfaqjeve. Tani edhe kritik, nuk shkon kjo punë! Cilësinë e vendosim me sistemin që krijojmë, nuk vendosim: mblidhemi dy vetë, bëjmë një shfaqje dhe doli keq. Kjo është një çështje në vazhdimësi kjo. Ashtu si juve, deputetëve, ju duhet një periudhë kohe të formoheni, edhe ne kemi nevojë për kohën tonë.

Kjo ka qenë një kërkesë e vazhdueshme jona. Kemi kontaktuar edhe forca politike. Jemi anatenuar në lidhje me këtë punë, pse i kemi takuar, jemi trajtuar si njerëz që do të kapim ca poste. Ja ku po jua them, ja ku po e deklarojmë këtui: asnjë post nuk duam! Nuk duam asgjë! Duam të mbrohet e drejta. Duam që ju të keni një vetëdije intelektuale, që ju të mbron vendin tuaj, të mbron kujtesën e tij historike, trashëgiminë, si dhe të jemi të gjithë krenarë për këto që kemi.

Kjo është e vetmja arsye pse jemi këtu dhe kjo na ka mbajtur gjallë deri më sot. Kjo është arsyeja pse na janë bashkuar njerëzit, pse na kanë besuar. Për këtë arsye kemi ndërmarrë iniciativë për të takuar forca të ndryshme politike, për t'i sensibilizuar deputetët, që shoh se u përgjigjen në mënyrë të shkëlqyer, sepse kemi humbur komunikimin bashkë dhe ju vazhduat punën. E kuptuat se duhet t'i futeni një studim. Ju lutemi, bëjeni edhe ju, deputetë të maxhorancës: lexoni, shikoni çfarë thonë të tjerët dhe binduni për këtë punë.

Kjo ishte arsyeja, kështu e filluam protestën dhe kështu do ta përfundojmë, sepse, në fund të fundit, këto janë mjetet tona. Ne nuk jemi parti dhe nuk do ta zgjidhim dot këtë punë. Ju do ta

zgjidhni, e kjo do të mbetet në nderin tuaj e të të gjithë shqiptarëve, në lidhje me mënyrën se si përfaqësohen.

Në qoftë se çështja do të marrë një drejtim kështu apo ashtu, do të thotë se ne atë meritojmë, megjithatë ne jemi të bindur se këtu do të ketë një vetëdije, do të ketë një reagim. Jam i bindur se në një moment të caktuar, nuk mund t'i shkohet çmendurisë deri në fund, sepse bëmë një revolucion në vitin 1990, përfunduam këtu ku jemi dhe pas 30 vjetësh po riktheheni më keq sesa ishit, keni humbur edhe ato pak vlera që kishit. Nuk i kemi më, po na flet paraja kudo. Jemi të rrethuar, na ka mbytur dhe nuk dalim dot. Mbi të gjitha jemi njerëz, kemi ndjenja, pastaj parane ta përdorim edhe për këtë.

Është e rëndësishme dhe nuk do të bëj leksione morali, por ju bëj një thirrje shumë të madhe, se njerëzit kanë nevojë për kulturë. Ju nuk e ndjeni, por ne që i kemi afër, pasi keni parasysh se çdo aktor nga mbrapa ka publikun e tij. Aktori sensibilizon shumë, sepse është në lidhje direkte me publikun. Ju nuk e keni kuptuar këtë, do ta kuptoni dalëngadalë. Kjo ishte arsyeja që ne kërkuam dëgjesa. Nuk jemi dëgjuar, nuk jemi marrë parasysh, jemi anashkaluar si disa njerëz arkaikë që duan të vjetrën, si disa njerëz që duan minjtë, më falni, minjtë kafshë janë, i dua, i ka krijuar Zoti, por nuk jemi këtu për të bërë diçka që nuk është, por jemi këtu për një gjë që u përket të gjithëve. Më besoni, besoni edhe te vetja juaj, sepse po besuat te vetja juaj, na keni shpëtuar të gjithëve! Ne jemi të bindur dhe do ta mbrojmë në kuptimin intelektual atë pronë, do të sensibilizojmë edhe njerëz të tjerë, intelektualë të tjerë, do të thërrasim edhe nga jashtë, meqenëse e kemi modën që të na e thonë të jashtmit se çfarë jemi. Kjo punë nuk shkon. Shumë njerëz nga Franca, Italia, Spanja më kanë kërkuar, unë nuk kam mjetet, por ka shumë mundësi të marrin avionin dhe të vijnë vetë këtu, për t'ju thënë se çfarë ndodh, sepse për një gjë të ngjashme në vendet e tyre, nuk bën vaki as ta çojnë nëpër mend të veprohet në këtë formë.

Faleminderit!

Albana Vokshi- Faleminderit!

Po bëj një sqarim. E para, dje nga unë si kryetare e komisionit për çështjet e kulturës, i është dërguar një letër drejtoreshës së Përgjithshme të UNESCO-s në lidhje me çështjen e teatrit, një thirrje për ndihmë dhe suport nga ana e UNESCO-s; i është dërguar një letër zyrtare kryetares së Komisionit Parlamentar të Parlamentit Europian për Çështjet e Kulturës; i është dërguar edhe personit përgjegjës në Këshillin e Europës për Çështjet e Kulturës. Sot, gjithashtu, do t'u dërgohen letra për t'ju mbështetur ju, në radhë të parë, por edhe për të mbështetur ruajtjen e trashëgimisë

kulturore shqiptare që, në fund të fundit, në kushtet kur Shqipëria kërkon të aderojë në Europë, nuk është vetëm çështje e ruajtjes së trashëgimisë kulturore shqiptare, por e trashëgimisë kulturore europiane. Ne do të vazhdojmë në të gjitha mënyrat, format institucionale, për t'i bërë thirrje si faktorit të brendshëm, ashtu edhe atij të jashtëm për t'u bashkuar në një kauzë, që mendoj se është e drejtë, sepse siç e thatë edhe ju, i kalon të gjitha barrierat politike, i kalon kufijtë e partive politike, është një çështje qytetare, kombëtare. Prandaj përtej partive politike, u bëj thirrje kolegëve që kanë ende kohë për të reaguar, për të ndryshuar mendimin e tyre, zonja Milva, për ta ruajtur Tiranën tonë, zemrën e Tiranës, që jo vetëm qytetarët, por fëmijët tanë, në radhë të parë, të mos na gjykojnë nesër se ne nuk mundëm të ruanim një vlerë të çmuar të Tiranës.

Elsa Demo - Në lidhje me atë se sa është kërkuar nga ky komunitet që të jetë në korrent të vazhdueshëm apo të përballet me ata që kanë marrë përsipër këtë përgjegjësi shumë të madhe shkatërruese, ju e dini shumë mirë se para se të fillonte historia e teatrit për çështjen e godinës, ka filluar historia e ligjit “Për artin dhe kulturën” dhe për shkak të presionit që komuniteti artistik tregoi, Ministria e Kulturës u tërhoq dhe tha se “Do të reflektojmë dhe do ta ndryshojmë këtë ligj”.

Albana Vokshi - Atëherë nuk kishte përfitime kaq të mëdha.

Elsa Demo - Ministrja e kulturës nuk ka ardhur...

Albana Vokshi - Nuk janë 205 milionë euro përfitime, prandaj janë tërhequr.

Elsa Demo - Në mirëbesim të të gjithë këtyre njerëzve, mendoj se po punohet për këtë projektligj konstruktiv, ndërkohë që puna e vërtetë po bëhet për këtë ligj shkatërrues. Çfarë transparence mund të pritët nga ministrja e Kulturës, kur ju kaq herë e keni thirrur në këtë komision dhe ajo nuk vjen?! Ju e dini shumë mirë, të gjithë e dinë se tani politika zhvillohet nëpërmjet teknologjisë, nëpërmjet ekranit, aty është realiteti politik. Ministrja e Kulturës ka bllokuar çdo komunikim të drejtpërdrejtë dhe ballafaques me njerëzit nëpërmjet medias. Një pjesë e medieve e dimë shumë mirë se çfarë raportesh kanë, sidomos tani, me kryetarin e Bashkisë së Tiranës dhe një pjesë e mirë e njerëzve nuk janë të informuar, një pjesë e mirë e tyre nuk e dinë se çfarë ka ndodhur me arkivin, fondet e Bashkisë së Tiranës, sepse i takojmë aty përditë në sheshin e oborrit të Teatrit dhe nuk e dinë se çfarë ka ndodhur, sepse shikojnë kanalet kryesore kombëtare që tregojnë vetëm njërën anë të medaljes. Më thoni: si mund të jetë i plotë ky komunikim? Thirrja ime e fundit: një kamikaz vret veten, vret edhe shumë të tjerë nga pas! Mos u bëni kamikazë!

Albana Vokshi - Po, zonja Duka.

Pastaj profesori, zonja Pampuri dhe këtu duhet ta mbylлим, sepse do të vazhdojmë me shqyrtimin nen për nen.

Valentina Duka – Në fillim dëshiroj të falënderoj artistët, gazetarët, akademikët! Jam pjesa juaj dhe realisht nuk më ka zënë gjumi mbrëmë, ndiej dhimbje që jam pjesë e parlamentit shqiptar që do të aporovojë ditën e enjte një ligj mostër. Po ju them se ky ligj nga titulli, nga forma dhe nga përmbajtja është mostër. Është ligji më keq i shkruar që ka ardhur ndonjëherë që kur jam deputete e këtij parlamenti. Ligji është shkruar nga njerëz, që nuk njohin gjuhën juridike, kanë një lloj përçarje, ndoshta duan të ngatërrojnë njerëzit për të mos kuptuar fenomenin. Po ju them se nga përmbajtja ligji është haxhiqamalist, prandaj do t’i kërkoj kolegut tim, zotit Nasufi, që është nga Berati, të kujtojë Haxhi Qamilitn që dogji bibliotekën e qytetit, kur të votojë ligjin. Të lutem mos e voto! Kujtohu se ligji ka karakter haxhiqamalist, ligji ka frymë esadiste...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, jo, erdhi në Berat dhe dogji bibliotekën. Ligji ka frymë esadiste dhe po përdor termin esadist, sepse ka qenë pjesë e rëndësishme e diskursit politik të javës së kaluar dhe e fjalorit politik të Kryeministrit. Kryeministri i Shqipërisë duhet ta dijë se Esad Toptani është politikan i fillimit të shekullit të kaluar, i vetmi në kohën e tij që ngatërroi pronën publike me atë private, ndërsa sot ka shumë të tillë. Prandaj, unë jam këtu për t’i thënë “jo” dhe do t’ju bëj vetëm një thirrje që ia bëj edhe vetes: t’i lutemi vetëm Zotit, se vetëm me biovalë dhe me fenomene paranormale mund të bëjmë për vete 3-4 veta atë ditë që të mos aprovohet ky ligj mostër haxhiqamalist dhe esadist.

Ju faleminderit!

Shezai Rrokaj– Për të gjitha ato fjalë që ju i adresuat komisionit, por, në fakt, nëpërmjet medieve edhe mbarë publikut, po ju them se, ashtu si Valentina, edhe unë vij nga bota akademike dhe e kuptoj thellësisht se çfarë do të thotë dhe çfarë vlere kanë krijimi, interpretimi, kultura dhe trashëgimia përballë atyre vlerësimeve, që ju i shikoni edhe në relacionin shpjegues, ku thuhet se ndërtesa është e pavlerë. Ne mund të shikojmë kështjella të rrënuara dhe teatro të rrënuar, që i përkasin antikitetit dhe është e vërtetë se ata nuk kanë vlerë materiale, por në fushën e kulturës mund të thuhet se vlera më e madhe që ato kanë është vlera shpirtërore. Kështu që jam thellësisht i prekur nga disa vlerësime në relacion dhe dua t’ju drejtohem posaçërisht juve, zonja avokate, lidhur me disa fakte që secilit prej nesh i kanë bërë përshtypje në këtë relacion. Për shembull, përse është përjashtuar Ministria e Infrastrukturës, e cila ka detyrë të drejtën zhvillimore, po ta pranoni

zhvillimin brenda zonës së mbrojtur, nga ky draft që u është lënë vetëm Ministrisë së Kulturës dhe Ministrisë së Ekonomisë? Kjo e fundit është pjesë e këtij drafti, por nuk është hartuese. Të drejtën e zhvillimit në thelb, për atë që do të pranohej si e tillë, duhej ta kishte Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Pra, a e quani normale që është përjashtuar kjo ministri?

Së dyti, nëpërmjet relacionit ne mësojmë disa shifra, që u ngritën edhe dje, përkatësisht 8465 metra katrorë trull shtetëror, nga i cili 2100 metra katrorë i përkasin bashkisë, por nuk dimë, pra jemi në terr informativ për pjesën e metrave katrorë që i takojnë sipërmarrësit. Ajo që më çon më tej në dyshime është fakti se po ngrihet një stuhi e tërë për prishjen e Teatrit dhe shumë mirë, por ne jemi në terr informativ se çfarë zhvillimi do të ketë aty. Askush nga ne nuk di sot se çfarë do të bëhet në pjesën tjetër, përveç Teatrit. Pra, shikoni se si është orientuar relacioni: t'i biem Teatrit, në mënyrë që të fshehim se çfarë do të bëhet në pjesën tjetër. Ju e kuptoni se nuk bëhet fjalë thjesht dhe vetëm për Teatrin. Këtu është një zonë zhvillimore. Pra, nuk mund të jemi thjesht dhe vetëm të interesuar për Teatrin, me gjithë respektin që kemi për ju dhe për veten, por kjo është një pronë publike dhe mendoj se problemi duhet shtruar më gjerë.

Pyetja ime është: në relacionin shpjegues nuk ka fare informacion për pjesën tjetër, që do të prishet dhe do të ndërtohet, pra sa kulla, sa katëshe. Kjo më pas futet në disa parime themelore, që kanë të bëjnë me faktin se çfarë kuptojmë ne me ansambël, në kuptimin e VKM-s nr. 180? Çfarë kuptojmë me zonë të mbrojtur, në kuptimin e VKM-s nr. 325, në raport me çfarë do të zhvillohet dhe sa do të ruhet pjesa historike? Këtu mendoj se është gjithë thembra e Akilit. Po të shikojmë, ky relacion është bërë me shumë mungesë vëmendje, sa një herë e kemi 500 milionë çmimin e trullit dhe një herë e kemi 6 milionë euro. 500 milionë lekë, nuk janë 6 milionë euro, mund të jenë 4,2 milionë euro, por shqiptarët duhet ta dinë. Pra, ka një terr informativ për pjesën pas teatrit absurd, në absurditetin që rrethon gjithë pjesën tjetër. Kjo duhet t'i shqetësojë jo më pak deputetët dhe të gjithë shqiptarët, sepse e gjithë pjesa po përqendrohet tek Teatri.

Personalisht, mendoj se në qoftë se ai Teatër duhet prishur nga pikëpamja e strukturës, le të prishet, por ai mund të rijetësohet, siç ka ndodhur me shumë kështjella dhe me shumë monumente, të cilat janë rindërtuar, ashtu siç kanë qenë. Historia e trashëgimisë njihet saktësisht ndërhyrje të epokave, të kohëve të tjera, duke ruajtur të njëjtën, si të thuash, staturë në raport me to.

Elsa Demo – Kush i ka dëgjuar këto alternativa? Nuk i ka dëgjuar askush. Këto propozime nuk i ka kërkuar njeri.

Shezai Rrokaj – Dua disa shpjegime lidhur pikërisht me këto kundërsense të relacionit dhe në raport me ruajtjen e ansamblit të trashëgimisë.

Albana Vokshi – Ju lutem, të mos futemi në çështje teknike, sepse i kemi të gjitha nenet. Informacionet nuk na i kanë dhënë. Kemi kaq ditë, kaq muaj që kërkojmë një informacion, një projekt dhe nuk na i kanë dhënë.

Të lutem, Orjola shkurt, sepse më duhet të mbyll pjesën e parë!

Faleminderit!

Orjola Pampuri – Atëherë, unë dua të falënderoj të gjithë artistët dhe, sinqerisht, me shpirt, jam me ju!

Në fakt, unë nuk do të doja kurrë që arti të ishte ose, më saktë, të ngatërrohej me pragmatizmin dhe nuk dua ta mendoj një gjë të tillë. Unë isha krenare dhe ndihesha mirë kur të gjithë aktorët dhe të gjithë artistët ishin bashkë në fillim të kësaj beteje dhe nuk ndihem mirë që sot disa prej tyre i janë larguar kësaj beteje. Megjithatë, jam e sigurt që pranë jush do të jenë të gjithë qytetarët dhe e gjithë opozita deri në fund të kësaj beteje. Projektligji vjen të enjten për t'u votuar dhe jam e bindur se maxhoranca, ashtu sikurse ka votuar të gjitha projektligjet në kokën e saj, edhe këtë do ta votojë.

Megjithatë, unë dje jam ndier keq edhe nga një prononcim i Kryeministrit, i cili më indinjoi: “Nuk ka pse të pyeten artistët dhe qytetarët. Ai vendim është marrë!” Ky është vërtet kulmi, madje kjo të bën të mendosh se po jetojmë jo në një vend pluralist, por në një vend komunist! Nuk ka arsye! Ajo skenë është e artistëve! Ajo skenë është aty ku të gjithë aktorët kanë zemrën dhe të gjithë qytetarët janë dashamirësit e asaj skene. Pra, janë ata të parët që vendosin, nuk ka punë Kryeministri; nuk ka punë asnjë deputet të vendosë për të ardhmen e atij teatri!

Ne shkojmë në Vjenë, të nderuar zotërinj, dhe të gjithë dyndemi për të parë shtëpinë dhe bibliotekën e Frojdit, e cila është qindravjeçare. Ne shkojmë në të gjitha vendet e Europës dhe krenohemi duke parë ndërtesa të vjetra. Çfarë kulture do të ketë më ky komb? Cili do të jetë identiteti i këtij kombi?

A e dini ju se të gjithë ne lindim një ind, lindim nga asgjëja dhe ndërtohem nga ato vlera që na jep familja, shoqëria, kultura? Ku do të jetë identiteti ynë?

Unë kam lindur në Tiranë, prindërit e mi po ashtu. Të gjithë e kujtojmë rrugën për tek Teatri; të gjithë e kujtojmë fëmijërinë, kur prindërit na çonin për të parë ndonjë skenë teatrale, por

sidomos na çonin për të harruar të gjitha ato vuajtje që na sillte komunizmi. Teatri ishte i vetmi tempull në të cilin gjendeshim mirë për ato pak çaste në të cilat kalonim.

Ju lutem edhe ju, zotërinj deputetë të maxhorancës që jeni këtu, qeshja, nënqeshja, të vepruarit kundër dëshirës së këtyre artistëve, nuk na bën aspak të moralshëm!

Ata nuk po vijnë këtu të kërkojnë as rritje rroge, e cila është një masakër që u bëhet; nuk po vijnë këtu të kërkojnë asgjë tjetër, por po vijnë këtu për të kërkuar të mos priset një ndërtesë, e cila është e tyre dhe vetëm e tyre.

Unë dua t'i përgëzoj dhe t'u them se jam me gjithë shpirt e zemër me ta dhe do të jem deri në fund me ta, por edhe ju bëhuni më pak njerëzorë. Është totalisht çnjerëzore të jesh pro një akti të tillë, i cili është monstruoz!

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Robert Budina– Kam vetëm diçka në lidhje me përçarjen e artistëve.

Zotërinj deputetë, na keni vënë një peshë që nuk e mbajmë dot. Nuk e kuptojmë se çfarë bëjmë. Nuk jemi personazhe publikë si ju, që një fjalë gabim humb vota, por ne jemi njerëz që dalim në skenë dhe veprojmë në bazë të ndjeshmërisë sonë. Pra, na vutë një peshë dhe e interpretuat si përçarje.

Asnjë nga ata artistë nuk ka pasur qëllim as të shesë, as të blejë, sepse janë të vetëdijshëm që nuk e kanë këtë tagër. Ju e përdorët si të tillë. Nuk shkuan ata as për të shitur, as për të blerë. Ata shkuan për të thënë një fjalë: kujtoni se po bëni mirë apo..., ndërkohë ju u bëtë një fotografi dhe na i nxorët këta njerëz. Ju lutem, bëni pak kujdes, sepse janë miqtë tanë, janë njerëzit tanë dhe kanë investuar në këtë vend!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Faleminderit!

Ju lutem, jo më komente!

Sot ftuam disa prej përfaqësuesve të rezistencës qytetare, të cilët unë dua realisht t'i falënderoj në emrin tim, si qytetare e Tiranës, për të gjithë përkushtimin për të mbrojtur teatrin, për të mbrojtur qendrën historike!

Para se ju të largoheni, për të filluar pjesën e dytë të mbledhjes, dua t'ju sqaroj edhe një herë qëndrimin politik të Partisë Demokratike, por jam e sigurt se është i njëjtë me të LSI-së, sepse të paktën qëndrimin e kishim të përbashkët dje: ne jemi që ky projektligj të tërhiqet një orë e më

parë! Ne i kemi thënë: jo, jo dhe jo këtij projektligji, i cili është një akt antikushtetues, është një akt mafioz, është një akt kriminal, është një akt monstruoze, nëpërmjet të cilit do t'i vijë radha edhe zemrës së Tiranës, që do t'i jepet një privati, për të cilin po hartohet një projektligj i personalizuar për ta kullëzuar!

Pra, teatri në vetvete është thjesht preteksti që ka gjetur Edi Rama, por, në fakt, nuk është ajo çështja! Por janë të gjitha pronat publike, që më takojnë mua, i takojnë Joridës, Florit, pra të gjithë neve që jemi qytetarë të Tiranës. Ndaj duhet të luftojmë që ta ruajmë të gjithë pjesën historike të Tiranës.

Duke thënë këtë, ne kemi votuar dje në parim kundër, si dhe në të gjitha komisionet, ku është votuar në parim, të gjithë deputetët e PD-së dhe të LSI-së kanë votuar kundër. Ndërsa, për fat të keq, deputetët e maxhorancës kanë votuar pro tij në parim, me urdhër.

Sot vazhdojmë të jemi kundër dhe do të vazhdojmë t'i kërkojmë maxhorancës që ta tërheqë këtë projektligj. Kemi menduar që të vazhdojmë të qëndrojmë në diskutimet nen për nen, e para, për të bërë transparencë për vjedhjen e madhe dhe, e dyta, për mënyrën se si do të vidhet, se si do të shkelen tre-katër ligje të tjera, se si do të shkelen nenet e Kushtetutës, për t'i bërë publike të gjitha shkeljet ligjore, shkeljet kushtetuese, ndoshta edhe për të bindur ose për t'i bërë thirrje në mënyrë të vazhdueshme maxhorancës që për një, dy, tre, pesë, dhjetë apo njëqind arsye ta tërheqë këtë projektligj, ta tërheqë sot, sepse ka ende kohë për të reaguar.

Edhe një herë, dua t'ju falënderoj shumë jo vetëm që erdhët sot këtu, por edhe për rezistencën tuaj! Do të na keni në krah jo vetëm sot, por do të na keni në krah në betejën tuaj, që unë shpresoj shumë që ta fitojmë!

Njëkohësisht, u bëj thirrje deputetëve të maxhorancës, pasi kanë ende kohë për të ndryshuar mendimin e tyre, madje dua të huazoj këtu një shprehje të Elsës, në mos gaboj: “Mos u bëni edhe ju kamikazë”!

E mbyllim këtu pjesën e parë.

Do të bëjmë vetëm dy minuta pushim sa të...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Urdhëroni!

Apollon Barçe – Dua të them vetëm diçka në plotësim të diskutimit. Unë kam gërmuar teatrin e Adrianopolit, gurë të vjetër janë, dymijë e sa vjet, dhe aty u vu shfaqja “Baccanale” nga

një trupë italiane. Ka qenë një gjë me të vërtetë shumë prekëse. Mendoni që në lashtësi është luajtur po ajo dramë e Eskilit.

Do t'u drejtohesha deputetëve socialistë me një shprehje nga “Princi i vogël” i Exupéry-së: “Mendoni me zemër, jo me mendje, sepse mendja edhe të gabon, zemra nuk gabon asnjëherë”. Për ta mbyllur, siç thonë amerikanët: *Be yourself!*

Albana Vokshi – Shumë faleminderit!

(Mbyllet pika e parë e rendit të ditës)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 03.07.2018, ora 12:30

Drejton mbledhjen:

Albana Vokshi – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Fillon diskutimi dhe votimi nen për nen dhe ne tërësi i projektligjit "Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt "Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar" (*komision për dhënie mendimi*).

Marrin pjesë:

Albana Vokshi, Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Fatmir Velaj, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhambulla, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Nora Malaj, Kejdi Mehmetaj dhe Sezai Rrokaj.

Të ftuar:

Edmond Ahmeti - Drejtor në Drejtorinë e Koncesioneve, Prokurimeve dhe Partneriteteve në Ministrinë e Kulturës,

Fatmir Hoxhaj - Drejtor i Administrimit të Pronës në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë,

Stefan Koçollari - Përgjegjës sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

(Vijon pika e dytë e rendit të ditës)

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Albana Vokshi – Është i pranishëm Edmond Ahmeti, drejtor në Drejtorinë e Koncesioneve, Prokurimeve dhe Partneriteteve, në Ministrinë e Kulturës.

Nga Ministria e Financave kanë ardhur Fatmir Hoxhaj, drejtor i Administrimit të Pronës dhe Stefan Koçollari, përgjegjës sektori në këtë ministri.

Po rifillojmë mbledhjen.

E para, ku janë informacionet që tha se do t'i sillte Ministria e Kulturës? Dje sekretari i Përgjithshëm tha se brenda ditës së djeshme, do të dërgonte projektin e kompanisë “Fusha” dhe analizën dhe studimin që ka bërë ministria juaj për projektin.

Edmond Ahmeti – Besoj se kërkesa është duke u shqyrtuar dhe sipas parashikimit, do të vijë në rrugë zyrtare.

Albana Vokshi – Më falni! Cilën kërkesë shqyrtoni?

Edmond Ahmeti – Kërkesën për përcjellje dokumentacioni, që ju keni kërkuar dje.

Albana Vokshi – Jo, nuk e keni ju këtë tagër, sepse një komision parlamentar ka kërkuar një informacion, i cili duhet, në mënyrë që ne të shkojmë në diskutimin nen për nen të këtij projektligji. Dje sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës tha se brenda ditës së djeshme do të dërgonte informacionin për projektin e kompanisë “Fusha”. Ju nuk e shqyrtoni dot këtë kërkesë, por vetëm duhet të sillnit informacionin. Ku është informacioni, projekti dhe analiza? Pse nuk i bëni publike? Pse nuk ia bëni të ditur komisionit parlamentar?

Edmond Ahmeti – E nderuar zonja kryetare,

Siç ju thashë, kërkesa vjen në mënyrë zyrtare dhe besoj se do të jetë duke ardhur apo duke u depozituar, sipas kërkesës suaj. Kaq mund t’ju them për këtë pjesë.

Albana Vokshi – Më falni! Ishte një kërkesë, e cila u bë në mbledhjen e komisionit. Çfarë do të shqyrtoni ju? Ku është projekti? Ju a e keni projektin aty?

Edmond Ahmeti – Jo.

Albana Vokshi – Për çfarë do të flisni sot ju?

Edmond Ahmeti – Unë kam ardhur për të përfaqësuar institucionin e Ministrisë së Kulturës për sa më keni thirrur, për diskutimin nen për nen të këtij projektligji.

Albana Vokshi – Ku është ministrja dhe zëvendësministri, sepse ky është një projektligj, i cili ka vendime politike?! Ju nuk jeni fare person politik që të na jepni mendimin tuaj. Ju jeni administratë, apo jo?

Edmond Ahmeti – Po.

Albana Vokshi – Ku është ministrja dhe zëvendësministri? Pse nuk janë paraqitur?

Edmond Ahmeti – Në lidhje me prezantimin e projektligjit, zonja ministre me të gjithë ekipin e saj politik dhe administrativ ishte dje dhe bëri të gjitha prezantimet e mundshme për parashikimet e këtij projektligji.

Nora Malaj – Kjo nuk ka pikë korrekte. Ky është vazhdimi i radhës i fyerjes institucionale që bëhet nga Ministria e Kulturës së Shqipërisë për qendrën më të rëndësishme, për Teatrin Kombëtar. Unë u propozoj kolegëve të mi, që këtë teatër absurd të mos ta vazhdojmë më. Ne e votuam në parim dhe mua më duket vazhdimi i një absurdi të turpshëm me këtë histori. Kërkoj ndjesë, se nuk e kam me ju! Ju keni tagrin tuaj, keni aftësitë tuaja në pozicionin tuaj, jeni pjesë teknike, por për sot, ne vendosëm dje të bënim një marrëveshje për të realizuar votimin në parim, në mënyrë që nen për nen të thoshim deri në fund, jo vetëm merakun tonë, por merakun e të gjithë votuesve dhe ta sqaronim qartësisht, në mënyrë që ministria të mos bënte fajin më të madh, për të cilin do ta ndëshkonte nesër historia.

Ne nuk mund të tallemi kështu, të vijmë, të marrim përsipër të diskutojmë nen për nen, të kemi mundësinë të bëjmë rregullime dhe të na thuhet se nuk keni mundësi të diskutoni. Kur do ta diskutoni ju, në kalendat greke? Do ta bëni diskutimin kur të mbarojë historia e ligjit? Për çfarë do të vini këtu? Pse vini kot?

Ju kërkoj ndjesë, por mua nuk më duket korrekte kjo!

Albana Vokshi – Kjo është një mungesë serioziteti, mungesë përgjegjësie dhe arrogancë. Unë nuk e di se ku po shkoni, duke shkelur procedurat dhe duke injoruar kërkesat e njëpasnjëshme të një komisioni parlamentar. Kjo nuk ishte kërkesë e një deputeti të opozitës, por ishte kërkesë e një komisioni parlamentar që ju të sillnit sot këtu projektin e kompanisë “Fusha”, analizën dhe studimin. Ju nuk e bëtë këtë.

E dyta, si mundet të mos jenë sot këtu zëvendësministri dhe sekretari i Përgjithshëm?

Jemi republikë parlamentare. Unë nuk e kuptoj se çfarë ka vlerë sot këtu?

Më vjen keq, por ne do ta mbyllim këtu këtë mbledhje komisioni, deri sa të paraqitet këtu një anëtar i kabinetit dhe të na japë sqarime, së bashku me informacionin e kërkuar. Unë kështu nuk kam se çfarë të diskutoj.

Më vjen keq, por e mbyll këtu këtë mbledhje komisioni.

Siguroni të vijë këtu përfaqësuesit politikë të kabinetit!

Edmond Ahmeti – A mund të shtoj diçka?

Albana Vokshi – Mbledhja është e mbyllur. Ju lutem, na jepni orën se kur do të vijë ministrja, anëtar i kabinetit, së bashku me informacionet që kemi kërkuar, që të rifillojmë diskutimin nën për nën të këtij projektligji!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ti nuk e vazhdon dot mbledhjen, se unë e kam mbyllur!

(Ndërhyrje pa mikrofon,)

Jo, çfarë votimi do të bësh ti?! Unë e kam mbyllur mbledhjen. Ti nuk e rifillon dot.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem!

Nesër në orën 9:00, kemi një mbledhje komisioni për të vazhduar...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk hidhet në votë, se unë e kam mbyllur mbledhjen!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem!

Nesër në orën 9:00, Milva?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Si do ta vazhdosh mbledhjen ti? Unë e kam mbyllur mbledhjen!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

MBYLLET MBLEDHJA

